



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 796/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 444/16 15.08.2016 e BPrAL "Kosovo Art Academy", si e pa bazuar.

II. Mbetet në fuqi vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) me Ref.: 647/16, datë 15.07.2016.

A r s y e t i m i

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) më datë 15.08.2016 ka pranuar kërkesë nga BPrAL "Kosovo Art Academy" për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Ref.: 647/16, datë 15.07.2016.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën BPrAL "Kosovo Art Academy" dhe ka vendosur të refuzoj si ta pabazuar, dhe me këtë rast ka lënë në fuqi vendimin e datës 15.07.2016, Ref.:647/16.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga BPrAL Kosovo Art Academy në lidhje me mos akreditimin institucional dhe të programeve të studimit: Dizajn/ BA 180 ECTS, Grafik Dizajn Multimedia/ BA 120 ECTS dhe Fotografi/ BA 180 ECTS. KSHC ka konstatuar se ky institucion nuk ka sjellë asnjë dëshmi e cila do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të BPrAL Kosovo Art Academy është trajtuar me saktësi nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit dhe se argumentet e ekspertëve për mos akreditimin e programit të studimit janë ofruar në Raportin Final të Ekspertëve të pranuar më datë 27.06.2016.

Për sa i përket stafit akademik të vendosur si bartës të programeve në vendimin e KSHC-së, ju njoftojmë që emrat e cekur në këtë vendim janë marr nga aplikacioni të cilin BPrAL "Kosovo Art Academy" e ka dorëzuar për aplikim më 30.09.2016, dhe personat në fjalë janë caktuar nga institucioni si bartës të programeve. Me rastin e sjelljes së dokumentacionit të përmirësuar aplikues dhe dosjeve të stafit akademik, BPrAL Kosovo Art Academy ka vendosur që të ndryshojë bartësit e programeve të studimit si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Dizajn	BA	180	Agron Hajzeraj; Masar Kabashi; Ilir Murseli
2	Grafik Dizajn Multimedia	BA	120	Gureta Breznica; Gezim Muriqi; Dardan Luta
3	Fotografi	BA	180	Fahredin Spahija; Ujkan Hysa; Fatmir Behrami

Ky është nja gabim teknik i lëshuar nga AKA në vendimin e KSHC-së ndërsa në dokumentacionin aplikues dhe bazën e shënimeve të AKA-së, emrat e mësipërm janë valid.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL "Kosovo Art Academy";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë